

V E N D I M
Nr.475, datë 22.7.1998

**PËR KRIJIMIN E INSPEKTORATIT TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE
SUPLEMENTARE**

Në mbështetje të nenin 44 të ligjit nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Inspektoratit të instituteve private të pensioneve suplementare, në vartësi të Këshillit të Ministrave.

2. Kompetencat e Inspektoratit dhe të inspektorëve caktohen në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve".

3. Inspektorati drejtohet nga kryeinspektori, i cili ka statusin e drejtorit të drejtorisë. Kryeinspektori emërohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Struktura, organika dhe përbërja e Inspektoratit të instituteve private të pensioneve private miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

4. Ngarkohet Inspektorati i instituteve private të pensioneve suplementare që, sipas kompetencave të përcaktuara në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995, të hartojë dhe të paraqesë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave rregulloren përkatëse, që lidhet me licencimin, kontrollin financiar, mbikëqyrjen dhe falimentimin e instituteve private të pensioneve suplementare, brenda datës 31.10.1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano